



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.384/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Blerim Grainca kandidat për deputet nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtuar nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 12:05, nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Vendvotimin nr.25291/02D subjekti politik LDK i ka pasur 88 vota, ndërsa nga formularët e publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor del se subjekti politik LDK i ka 0 vota.

Parashtruesi i ankesës thekson se, votat e fituara të subjektit politik LDK i janë shënuar subjektit politik me numër 17 dhe me këtë rast është dëmtuar subjekti politik LDK përfshirë edhe ai si kandidatë.

Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e votave në këtë kuti të votimit.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:


ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe pas hetimit gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 25291/02D nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, është konstatuar se kandidati me nr.49, nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka 15vota, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 15 vota të vlefshme .Nga gjendja e vërtetuar faktike rezulton se pretendimet në ankesë nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe si të tilla u refuzuan.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 384/2017 më datën 02.07.2017

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.